

Ftesë për shprehje të interesimit

Grantet për aktivitetet e bashkëpunimit ndërkomunal

1. UNDP-ja dëshiron që të ftojë Komunitet e interesuara që të dorëzojnë shprehjen e interesimit për grante për Bashkëpunim Ndër-Komunal gjat më 19 Shtator të vitit 2011 në ora 17:30.
2. Udhëzuesi operacional (dhe kriteret e vlerësimit) mund të gjenden në: www.ks.undp.org.

Komunitet e interesuara duhet të plotësojnë **formularin për shprehje të interesimit** (Shtojca 2) në përputhje me **Udhëzuesin Operacional për aplikim** (Shtojca 1) dhe të dërgohet në këtë adresë:

UNDP Kosovë
Projekti "Përkrahja e decentralizimit në Kosovë"
Grante për aktivitetet e bashkëpunimit ndërkomunal
Qyteza Pejton 14, 10,000 Prishtinë

UNDP
Projekti "Përkrahja e decentralizimit në Kosovë"

Shtojca 1

Udhëzuesi operacional për aplikim

Grantet për aktivitete të bashkëpunimit ndërkomunal – Skema e granteve BNK

KONCEPT DOKUMENT

Skema e grantit PËR AKTIVITETET E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL APO OFRIMIN MË TË MIRË TË SHËRBIMEVE UNDP Kosovë, qershor 2011

1. Konteksti

Si rezultat i reformës në decentralizim, komunat janë duke pranuar çdo herë e më shumë kompetenca nga qeveria qendrore, që krijon përgjegjësi dhe detyra të shumta për të gjitha komunat si dhe pritje për disa shërbime publike të cilat duhet të ofrohen në nivelin lokal për qytetarët. Përderisa të gjitha komunat kanë përgjegjësitë e barabarta para ligjit, kapacitetet e tyre janë mjaft të larmishme. Disa komuna janë themeluar rishtazi, e disa prej tyre si rezultat i Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Ndarja e pasurive, resurseve njerëzore dhe financiare në shumë raste ende është në vazhdim e sipër dhe një numër i shërbimeve ende ofrohen në mënyrë joformale apo gjysmëformale (si gjest i vullnetit të mirë) nga komunat “amë”.

Konteksti i sipërm nënkupton nevojën për aplikimin e mjeteve lokale për ofrimin e shërbimeve që do të mundësojnë komunat të plotësojnë mungesën e kapaciteteve njerëzore, organizative dhe financiare për ofrimin efikas të shërbimeve. Në veçanti komunat e reja dhe rurale kanë nevojë për zgjidhje alternative institucionale për ofrimin e shërbimeve me qëllim që të kapin hapin me komunat e themeluara më parë e kështu t’i ofrojnë qytetarëve të tyre gjasë të barabartë për qasje në shërbime dhe zhvillim. Ky nocion është në veçanti i rëndësishëm për të konsoliduar strukturat e qeverisjes lokale në komunat e reja, pasi që qytetarët nuk duhet të ndjejnë regresion në cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe të humbasin besimin në kapacitetet e institucioneve të tyre lokale.

Një nga instrumentet që shfrytëzohet më së shumti në rajon dhe në shtetet e BE-së për të tejkaluar mangësitë në kapacitete, përderisa ruhet autonomia e njësive lokale, është bashkëpunimi ndërkomunal. Ky pohim përkrahet nga një numër i shembujve që janë regjistruar dhe koduar, përfshirë përvojat nga fqinjët, siç është Maqedonia. Shembuj të bashkëpunimit ndër-komunal mund të gjenden në faqen: <http://kk.rks-gov.net/imc/default.aspx?lang=en-US>. Në shumë raste, ky mjet ka kontribuar jo vetëm përmirësimit të cilësisë, efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve ekzistuese, por madje edhe ka ofruar shërbimet të cilat përndryshe nuk do të mund të ofroheshin fare. Rastet kanë demonstruar kthim relativisht të shpejtë të investimit fillestar (kryesisht nga kursimet e optimizimit të strukturave menaxhuese dhe stafit, reduktimit të shpenzimeve operacionale dhe të mirëmbajtjes, ngritjes së shkallës së inkasimit të tatimeve, menaxhimit më të mirë, shfrytëzimit më të mirë të pajisjeve dhe ekspertizës...). Marrëveshjet për BNK rezultojnë në ekonomi të shkallës, kapacitete adekuate administrative dhe të resurseve njerëzore, organizim më të mirë të proceseve në ofrimin e shërbimeve dhe kënaqshmëri të qytetarëve. Procesi i përvijimit të proceseve administrative dhe kapaciteteve të resurseve njerëzore i siguron komunave bazë solide për të arritur certifikimin e standardeve të cilësisë për ofrimin e shërbimeve (ISO 9001-2000). Nuk është më pak i rëndësishëm fakti se shërbimet e përmirësuara të cilësisë apo zgjerimi i fushëveprimit të shërbimeve nuk matet doemos me resurse financiare, por nga kënaqshmëria e qytetarëve, përfshirë përfitimet nga grupet e rrezikuara.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale i Republikës së Kosovës dhe Ligji i ardhshëm për bashkëpunimin ndërkomunal konfirmon tutje rëndësinë e këtij mjeti për kontekstin e Kosovës. Propozimi i ligjit konfirmon përkufizimin standard të BNK-së si bashkëpunim të vendosur në mes të dy apo më shumë komunave për qëllime të ofrimit më të mirë të shërbimeve për qytetarët dhe promovimin e zhvillimit lokal në mënyrë më efikase dhe efektive. Ligji i propozuar tutje përkufizon objektivat, konceptin dhe format e BNK-së, dhe hapat që kërkohen për përmbylljen e marrëveshjeve për BNK. Në këtë kuptim ky dokument mund të shihet si udhëzues i mirë për përmbylljen e marrëveshjeve të qëndrueshme për BNK përderisa ruhet kontrolli individual i strukturave të krijuara.

Rëndësia e BNK-së si instrument për të ndihmuar komunat e reja dhe rurale që të bëhen të qëndrueshme është vërtetuar edhe nga Studimi i sfidave dhe mundësive të BNK-së në Kosovë, që është kryer nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në Shtator 2010 (http://www.komunat-ks.net/dokumentat/20101005_131408_2.pdf).

Tutje, disa forma të bashkëpunimit ndërkomunal mund të shihen tanimë në zbatim, por gjithmonë duke u bazuar në marrëveshjet joformale të kryetarëve të komunave apo përmes memorandumeve shumë të përgjithësuara të mirëkuptimit të cilat nuk specifikojnë marrëveshjet e menaxhimit apo të llogaridhënies. Përderisa ky është sinjal i mirë që kryetarët e komunave janë inovativ dhe të hapur për bashkëpunim, këto marrëveshje joformale sjellin një numër të rreziqeve: paparashikueshmëria e kohëzgjatjes së marrëveshjes, mungesa e instrumenteve për menaxhimin e ofrimit të shërbimeve dhe sigurimin e cilësisë, dhe mangësitë në llogaridhënie në lidhje me kompetencat e realizuar apo të përealizuara.

2. Objektivi dhe fusha e skemës së grantit

Sa i përket objektivit të përgjithshëm të Programit të UNDP-së për Përkrahje të Decentralizimit, skema e grantit për bashkëpunimin ndërkomunal do të përkrahë promovimin e bashkëpunimit ndërkomunal si mjet për krijimin e komunave të qëndrueshme përmes ndërtimit të kapacitetit të administratës komunale dhe ofrimit të barabartë të shërbimeve në nivelin lokal në Kosovë.

Skema e grantit jo vetëm që do të ofrojë përkrahje financiare për komunat, por gjithashtu edhe asistencë teknike për hartimin e marrëveshjeve solide dhe të qëndrueshme ndërkomunale në aspektin institucional, ku marrëdhëniet e komunave partnere do të rregullohen si duhet dhe do të mbrohen interesat e të gjitha komunave partnere. Partnerët kryesor në këtë aktivitet janë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, AKK-ja dhe komunat.

Skema e granteve do të vë në shënjestër veçanërisht komunat e reja dhe të vogla. Atyre do t'u jepet rasti për t'u bërë partnere me ndonjë komunë tjetër me qëllim të bashkimit të forcave në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve.

3. Kriteret e pranueshmërisë

3.1 Fushat dhe format e bashkëpunimit ndërkomunal:

Skema e grantit do të përkrahë projektet që synojnë krijimin e marrëveshjeve institucionale për bashkëpunim për rritjen e kapaciteteve administrative për ofrimin e shërbimit në kuadër të gamës së kompetencave të tyre.

Iniciativat që duhet të financohen duhet të pasqyrojnë qartë karakteristikat e mëposhtme:

- Interesimi i dyanshëm, shërbimet dhe aktivitetet e përbashkëta në mes të dy apo më shumë Komunave
- Përqendrimi në një apo më shumë kompetenca komunale (sipas nenit 17 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale)
- Ndarja e qartë e roleve, resurseve dhe përgjegjësisë të komunave partnere
- Indikacioni i qartë i formës administrative të bashkëpunimit ndërkomunal, përfshirë marrëveshjet për menaxhim dhe llogaridhënie, ndarjen e rreziqeve, kontrolli dhe përfitimet

Pranohen projektet që synojnë krijimin e formave të poshtme të bashkëpunimit ndërkomunal:

- Krijimin e organeve të përbashkëta të punës
- Krijimin e organeve të përbashkëta administrative dhe organizative
- Krijimin e sistemit të shërbimeve të përbashkëta publike
- Krijimin e marrëveshjeve për ofrimin e shërbimeve nga një komunë për një apo më shumë komuna tjera
- Krijimin e marrëveshjeve për ofrimin e shërbimit nga ndonjë ndërmarrje private apo publike në emër të një apo më shumë komunave

Nga shprehja e interesimit inkurajohen aktivitetet e poshtme të aktiviteteve:

- ndihma për aktivitetet përgatitore dhe ndërtimi i konsensusit në mesin e partnerëve
- kryerja e vlerësimit për nevojat dhe përfitimet e BNK-së
- kryerja e studimeve të arsyeshmërisë (kosto/përfitimi), analiza bazë, programet e përbashkëta zhvillimore në fushat e caktuara
- ofrimi i këshillave dhe shërbimeve eksperte për fushat dhe format e bashkëpunimit
- sigurimi i pajisjeve dhe softuerëve të domosdoshëm, për shërbime të përbashkëta

- ndërhyrjet e vogla në ndërtim që do të sigurojnë kushte më të mira pune për format e BNK-së (psh. ndërtimin e një posti të përbashkët për mbrojtjen e pyjeve)
- kryerja e aktiviteteve për ndërtim të kapacitetit (p.sh. trajnime, punëtori, prezantime, etj.)
- realizimi i fushatave lokale për ngritjen e vetëdijes
- realizimi i aktiviteteve tjera përkatëse sipas objektivave të përkufizuara sipas artikullit 17 ne Ligjin për Qeverisje Lokale në Kosovë

VËREJTJE: UNDP-ja dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës do t'i ofrojnë komunave asistencë teknike në shtjellimin e hollësive të marrëveshjeve të caktuara administrative. Shembujt e marrëveshjeve të vërteta të BNK-së si dhe mjeteve që do tu sigurohen komunave, dhe mbajtja e seancave informative. Të gjitha informatat mund të gjenden në faqen e veçantë në internet të BNK UNDP/MAPL: <http://kk.rks-gov.net/imc/> . Shembuj tjerë nga Maqedonia mund të gjenden në: www.imc.org.mk

3.2 Kush mund të aplikojë

Të gjitha komunat mund të aplikojnë në këtë raund të skemës së grantit BNK, me kusht që partneriteti BNK përfshinë një apo më shumë komuna të poshtëshënuara të vogla apo të porsakrijtura, d.m.th. komunat në shënjestër:

- Graçanica
- Hani Elezit
- Juniku
- Kllokoti
- Mamusha
- Novobërda
- Parteshi
- Ranillugu
- Shtërpca
- Si dhe Dragashi (i financuar nga një projekt i vecantë i UNDP-së: Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i zhvillimit të qëndrueshëm të përdorimit të tokës në Projektin Dragash)

(p.sh. komuna e Graçanicës mund të aplikojë për partneritet me komunën e Prishtinës apo Lipjanit dhe me komuna tjera. Rekomandohet partneriteti me komunat fqinje.

3.3 Kush nuk mund të aplikojë

Organizatet profitabile në veçanti kompanitë e sektorit privat (konsulentat, ndërmarrjet individuale, individët, etj.) si dhe organet e qeverisë qendrore (ministritë, agjencitë, etj.), organizatat joqeveritare (OJQ-të), odat ekonomike dhe organizatat tjera të ngjashme nuk pranohen të aplikojnë në emër të tyre apo të komunës. Aplikacionet e dorëzuara nga partnerë. Sidoqoftë, këto subjekte mund të kontrahohen nga komuna si partner implementues për ofrimin e aktiviteteve të propozuara specifike.

Çështjet tjera që ndërlidhen me pranueshmërinë për financim

Grantet do të jenë dispozicion vetëm për projekte me objektiva jokomerciale që në asnjë mënyrë nuk janë profitabile. Granti në asnjë mënyrë nuk mund të jepet për përfitime.

Njëkohësisht në një propozim mund të marrin pjesë dy apo më shumë partnerë. **Të gjitha komunat e synuara nga pika 3.2 të këtij koncept dokumenti do të kenë rastin që të pranojnë fonde për një projekt/iniciativë të përbashkët (d.m.th. raundi i parë i skemës së grantit do të përkrahë më së shumti 10 iniciativa gjithsej).**

Gjithmonë duhet që njëra komunë të caktohet partnere si aplikuesi udhëheqës në mesin e komunave. Aplikuesi udhëheqës ka përgjegjësinë e përgjithshme që të koordinojë dhe të drejtojë projektin (menaxhimi financiar dhe teknik), dhe të veprojë si pikë kryesore e kontaktit dhe komunikimit me UNDP-në. Të gjitha komunat e përfshira në projektin e miratuar do të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit për grant me Zyrën e UNDP-së brenda vendit.

3.5 Çfarë projekti BNK nuk pranohet (nuk mund të financohet)?

Llojet e poshtme të projekteve nuk pranohen dhe nuk mund të financohen:

- Projektet BNK që nuk janë në kuadër të fushave të pranueshme dhe që nuk janë të formave të dhëna në këtë dokument
- Financimi për projektet që tanimë ka filluar (financimi retrospektiv).
- Projektet e aktiviteteve politike apo ideologjike apo të natyrës ekskluzivisht fetare
- Shfrytëzimi i granteve për të dhënë grante apo hua entiteteve tjera juridike
- Themelimin e kompanive private
- Konferencat apo punëtoritë që mbahen vetëm një herë (konferencat apo punëtoritë mund të financohen vetëm nëse janë pjesë e aktiviteteve më të gjera të zbatuara gjatë kohëzgjatjes së projektit të propozuar për asistencë). Njësoj, botimi i materialeve në lidhje me konferencat apo punëtoritë jashtë fushës së aktiviteteve të miratuara, d.m.th. nuk financohen
- Projektet që përqendrohen vetëm në blerjen e pajisjes apo në infrastrukturë të vogël
- Projektet që përqendrohen në blerjen e tokës, ndërtesave apo lokaleve.

3.6 Si të aplikoni

Komunat e interesuara duhet të plotësojnë formularin e bashkëngjitur 'Shprehja e Interesimit' në Shtojcën 2, dhe të theksojnë idetë fillestare si dhe komunat partnere, në bazë të së cilave UNDP-ja me partnerët përcakton se cilat iniciativa plotësojnë pakon e kriterëve dhe mbajnë Seanca ballë-përballë në zhvillimin dhe finalizimin e projekteve/iniciativave të përbashkëta.

4 Kohëzgjatjen e projekteve

Kohëzgjatja e secilit projekt nën këtë skemë të grantit është më së paku 6 dhe më së shumti 9 muaj. Projekti duhet të dizajnohet në aso mënyre që siguron qëndrueshmëri, d.m.th. vazhdimin e funksionimit pas përfundimit të përkrahjes nga UNDP-ja (që është një nga arsyet pse kërkohen marrëveshjet BNK brenda kohëzgjatjes së projektit).

5 Vlera e projekteve

Vlera minimale e grantit do të jetë 5,000 € dhe vlera maksimale e një granti të përbashkët është 20,000 €. Bashkëfinancimi nga aplikuesit (komunat) prej së paku 15% të kostos totale të projektit është **i detyrueshëm** dhe mund të bëhet në të gatshme apo në natyrë. Bashkëfinancimi në natyrë mund të bëhet në formë të rrogave të stafit të brendshëm (për stafin e përfshirë në projekt), qiramarrjen e lokaleve që shfrytëzohen për projektin, amortizimin e pajisjeve që shfrytëzohen për projektin, shpenzimet tjera (kostot e telekomunikimit, rryma elektrike, administrata dhe kontabilitetit i drejtpërdrejtë me projektin), etj. Bashkëfinancimi mund të tejkalojë 15%, nëse ekziston interesimi dhe nëse ka fonde në dispozicion nga komunat partnere.

6 Menaxhimi i skemës së grantit

Skema e grantit do të jetë iniciativë e partneritetit në mes të UNDP-së, MAPL-së dhe AKK-së. UNDP-ja do të dizajnojë udhëzimet për aplikacionet për projekt, siguron asistencën teknike në përgatitje të projekteve, menaxhimi i marrëveshjeve kontraktuese me komunat përfituese dhe siguron kontrollin e cilësisë në zbatimin e projektit, mbledhjen e përvojave dhe mësimëve të nxjerra.

Skema e grantit do të shpallet bashkërisht nga UNDP-ja, MAPL-ja dhe AKK-ja.

Ministria do të jetë partneri udhëheqës në anën e qeverisë. Një përfaqësues i Ministrisë do të merr pjesë në shqyrtimin e propozimeve për projekt së bashku me UNDP-në. Ministria gjithashtu do të sigurojë asistencë teknike gjatë zbatimit të projektit, në veçanti në formulimin dhe miratimin e marrëveshjeve BNK. Ministria gjithashtu do të asistojë në ofrimin e asistencës teknike dhe këshillave nga ministritë përkatëse të linjës apo agjencive gjatë zbatimit të projektit.

AKK-ja do të jetë katalizatori kryesor në anën e komunave. Ajo do të angazhohet me UNDP-në për të ndihmuar procesin e inicimit të partneriteteve BNK përmes aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes, shpërndarjen e informatave, organizimit e ngjarjeve informative dhe të trajnimit, ndihmën e përditshme për komunat në përgatitjen e projekteve dhe në grumbullimin, kodimin dhe shpërndarjen e shkaqeve dhe mësimëve të nxjerra.

7 Programi indikativ i zbatimit

Nr.	Aktivitetet	Koha	Palët përgjegjëse
1.	Ngjarjet përgatitore-informative për qëllimin dhe fushëveprimin e skemës së grantit për komunat	Korrik 2011	UNDP, MAPL, AKK
2.	Shpallja e skemës së granteve për komunat	Korrik 2011	UNDP, MAPL, AKK
3.	Identifikimi i komunave partnere të pasuara nga seanca e përbashkët informative për shprehjen interesimit dhe aplikacionet e projektit (në bazë të përvojave nga Maqedonia, me përfshirjen e komunave dhe ekipeve BNK nga Maqedonia)	Korrik - Gusht 2011	UNDP, AKK, MAPL
4.	Zhvillimi i projekt propozimeve të plota me asistencë teknike nga Projekti 'Përkrahja e decentralizimit në Kosovë' i UNDP-së dhe AKK-ja si dhe partnerët – Asociacioni i Komunave të Kosovës	Korrik-Gusht Shtator 2011	UNDP, MAPL, AKK
5.	Vendimi final i projekt propozimeve nga UNDP-ja dhe Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal	Shtator 2011	UNDP dhe MAPL
6.	Kontraktimi	Shtator 2011	UNDP
7.	Fillimi i zbatimit	Shtator 2011	Komunat
8.	Monitorimi dhe vlerësimi	Shtator 2011 – gjer në fund të projekteve BNK	UNDP, MAPL
9.	Mësimet e nxjerra, shpërndarja e rezultateve, vlerësimi dhe planifikimi i së ardhmes.	Janar-Mars 2012	UNDP, MAPL, AKK

Shtojca 2: Formulari per Shprehje të Interesimit

Thirrje per Shprehje të Interesit

**Skema e grantit BNK -
PËR AKTIVITETE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL APO OFRIMIN MË TË MIRË TË
SHËRBIMEVE**

SHPREHJA E INTERESIMIT

A. PREZANTIMI I APLIKUESVE

(1) Komuna udhëheqëse aplikuese

Emri dhe hollësitë e kontaktimit të komunës udhëheqëse aplikuese.

Emri i komunës		MIRATIMI NGA KRYETARI I KOMUNËS UDHËHEQËSE
Emri i kryetarit të komunës		Përkrahë plotësisht dhe miratoj këtë shprehje të interesimit për skemën e grantit BNK 2011 nën Projektin e UNDP-së Përkrahja e Decentralizimit në Kosovë
Adresa		
Personi kontaktues		
Telefoni		
Faksi		
E-maili (personi kontaktues)		

(2) Komunitat partnere

Emri dhe hollësitë e kontaktimit të komunave partnere në aplikacion.

PARTNERI 1: Emri i komunës		MIRATIMI NGA KRYETARI I KOMUNËS PARTNERE
Emri i kryetarit të komunës		Përkrahë plotësisht dhe miratoj këtë shprehje të interesimit për skemën e grantit BNK 2011 nën Projektin e UNDP-së Përkrahja e Decentralizimit në Kosovë
Adresa		
Personi kontaktues		
Telefoni		
Faksi		
E-mail		

PARTNERI 2: Emri i komunës		MIRATIMI NGA KRYETARI I KOMUNËS PARTNERE
Emri i kryetarit të komunës		Përkrahë plotësisht dhe miratoj këtë shprehje të interesimit për skemën e grantit BNK 2011 nën Projektin e UNDP-së Përkrahja e Decentralizimit në Kosovë Nënshkrimi i kryetarit të komunës dhe vula e komunës
Adresa		
Personi kontaktues		
Telefoni		

B. TË DHËNAT PËR PROJEKTIN

(1) Përmbledhje e projektit

Titulli i projektit	
Kohëzgjatja e projektit	
Shuma e kërkuar nga granti i UNDP-së (EURO)	
Kostoja e përgjithshme e projektit (përfshirë kontributin vetanak) (EURO)	
Fusha(t) e bashkëpunimit	
Forma e BNK-së e cila pritet të vendoset	
Grupi i synuar – Përfituesit e drejtpërdrejtë	
Objektivat e projektit	
Aktivitetet e projektit (në përgjithësi)	
Rezultatet e projektit	

(Shënim: në tabelën e sipërme mund të shfrytëzoni më shumë hapësirë nëse shtypni ENTER në tastierë, por kufizohuni në jo më shumë se tri faqe për këtë tabelë)

Ku të dërgohen shprehjet e interesimit:

Shprehja e interesimit të plotësuara mund të dorëzohen personalisht apo të dërgohen përmes postës në adresën:

UNDP Kosovë
Projekti “Përkrahja e decentralizimit në Kosovë”
Grante për aktiviteteve të bashkëpunimit ndërkomunal
Qyteza Pejton 14, 10,000 Prishtinë

ose në e-mail adresën: rreze.duli@undp.org

Rreze Duli, Menaxhere e projektit
Përkrahja e decentralizimit në Kosovë
UNDP Kosovë
Pejton 14, 10,000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 249 066 270
Faksi: +381 38 249 065
rreze.duli@undp.org
www.ks.undp.org